

Në zbatim të nenit 29, të Statutit të Universitetit të Evropës Juglindore, Bordi i Universitetit, në mbledhjen e tij të mbajtur më 31.05.2019, e miratoi:

RREGULLOREN PËR PROCEDURËN E PUNËS SË BORDIT

I. Objekti i rregullimit

Neni 1

Qëllimi i kësaj rregulloreje është t'i përshkruajë procedurat për emërimin e anëtarëve të Bordit të Universitetit, thirrjen e mbledhjeve dhe çështjeve të tjera të ngjashme, të përcaktuara në Pjesën IV, nenet 22-29, të Statutit të Universitetit.

II. Emërimi i anëtarëve

Neni 2

- (1) Komiteti Ekzekutiv (KE) i Bordit të Universitetit e krijon Komitetin e Nominimeve (KN), i përbërë nga anëtarët aktualë të KE-së, të cilët do të takohen në mënyrë private në mungesë të Rektorit dhe anëtarëve të tjerë të Drejtorisë së Rektoriale, me asistencë logjistike të ofruar nga Zyra e shërbimit juridik.
- (2) KN-ja, në mënyrë rrjedhëse, do të takohet sipas kërkesave të Kryetarit të Bordit të Universitetit, me rastin e ndonjë vendi të lirë aktual ose të ardhshëm midis anëtarëve të Bordit të Universitetit, sipas nenit 22, paragrafit 5, pikës 1 dhe nenit 22, paragrafit 5 dhe pikës 3, të Statutit të Universitetit.
- (3) Kryetari i Bordit të Universitetit e kryeson KN-në.
- (4) Në instancën e parë të mandatit të ri për të gjithë Bordin e Universitetit, e cila fillon nga 1 shtatori 2020, atëherë në intervalet katërvjeçare, duke filluar nga 1 shtatori 2024, KN-ja do të rekomandojë anëtarët për emërim, ose riemërim në mbledhjen (verore) të Bordit ekzistues të Universitetit për vitin në fjalë.
- (5) KE e përcakton se si do të zbatohet procedura e konsultimeve nga KN-ja, sipas nenit 22, paragrafit 5, pikës 1, të Statutit, me trupa adekuate ndërkombëtare dhe/ose përfaqësues diplomatikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për identifikimin e kandidatëve të nominuar për dy anëtarët e Bordit të Universitetit, përkatësisht nga vendet evropiane dhe SHBA. KN-ja, do t'i rekomandojë Bordit të Universitetit dy emra për konfirmim në kohën e duhur.
- (6) KE e aprovon dhe e publikon thirrjen publike për emërimin e anëtarëve sipas nenit 22, paragrafit 5, pikës 3, të Statutit, d.m.th. anëtarë nga bashkësia shoqërore, duke i marrë parasysh dispozitat e nenit 22, paragrafit 5, pikës 4, të Statutit aty ku është relevante. KN-ja do t'i rekomandojë Bordit të Universitetit një emër sipas nenit 22, paragrafit 5, pikës 3, të Statutit, ose një emër të dytë sipas nenit 22, paragrafit 5, pikës 3, ose nominim alternativ nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas nenit 22, paragrafit 5, pikës 4, të Statutit për konfirmim në kohën e duhur.
- (7) Në shqyrtimin e rekomandimeve të tij për emërimet sipas nenit 22, paragrafit 5, pikët 1 dhe 3, të Statutit, KN-ja do t'i ketë parasysh funksionet e Bordit të Universitetit të përshkruara në nenin 22, paragrafin 2 dhe nenin 27, të Statutit si dhe profilin e

kandidatëve, që i pasqyron nevojat e Bordit të Universitetit për realizimin e qeverisjes efektive të Universitetit. Që të arrihet kjo, KN-ja mund të kërkojë nga Komiteti për çështje të stafit të Bordit të Universitetit "përshkrim të rolit" për anëtarët e Bordit të Universitetit.

- (8) Senati i Universitetit është përgjegjës për zgjedhjen e anëtarëve sipas nenit 22, paragrafit 5, pikës 2, të Statutit dhe këto nominime do t'i paraqesë Kryetari i Senatit në Bordin e Universitetit, në kohën e duhur.
- (9) Të gjithë personat që do të merren në konsideratë nga KN-ja, sipas nenit 22, paragrafi 5, pikëve 1 dhe 3, të Statutit, janë të detyruar ta paraqesin në KN çdo konflikt të mundshëm interesi midis çdo pozicioni që ata mbajnë jashtë Universitetit dhe anëtarësisht të tyre në Bordin e Universitetit.
- (10) Anëtarësimi fillestar ose i vazhdueshëm në Bordin e Universitetit, në të gjitha kategoritë sipas nenit 22, paragrafit 5, të Statutit është i papajtueshëm me ushtrimin e ndonjë funksioni në një parti politike.

III. Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarit të Bordit të Universitetit

Neni 3

Sipas nenit 23, të Statutit, Kryetari dhe Nënkyetari i Bordit të Universitetit zgjidhen sipas kësaj procedure:

- Sekretari i përgjithshëm e merr kryesimin e mbledhjes konstitutive (të parë), të Bordit të Universitetit dhe kërkon nga anëtarët e Bordit të Universitetit të bëjnë nominime për postet e Kryetarit dhe Nënkyetarit të Bordit të Universitetit;
- Kryetari i Bordit të Universitetit, nominohet nga radhët e anëtarëve të emëruar në bazë të nenit 22, paragrafit 5, pikës 1 dhe nënkryetari i Bordit të Universitetit nga radhët e anëtarëve të nominuar në bazë të nenit 22, paragrafit 5, pikës 2, të Statutit;
- Të emëruarit, do të tërhiqen nga mbledhja përderisa merren në konsideratë nominimet e tyre përkatëse;
- Pas zgjedhjes, Kryetari i Bordit të Universitetit e merr kryesimin.

IV. Thirrja e mbledhjeve

Neni 4

(1) Procedurat për thirrjen e mbledhjeve janë si më poshtë:

- Bordi i Universitetit vendos, një vit përpara, për datat e mbledhjeve të tij dhe këto data mund të ndryshohen vetëm nga një shumicë e thjeshtë e anëtarëve të Bordit të Universitetit, të marra në mënyrë elektronike nga Sekretari i përgjithshëm;
- Së paku tre javë para një mbledhjeje të planifikuar, Sekretari i përgjithshëm do t'i paraqesë një draft agjendë Kryetarit të Bordit të Universitetit;
- Pas miratimit të draft agjendës, agjenda përfundimtare dhe dokumentet për mbledhjen në mënyrë elektronike, do t'u shpërndahen anëtarëve të Bordit të Universitetit dhe të pranishmëve, të paktën shtatë ditë përpara;

- Anëtarët mund të paraqesin pikë shtesë për diskutim, të paktën dy ditë përpara mbledhjes;
 - Kryetari i Bordit, për zbatim më të efektshëm të mbledhjes, mund që në çdo kohë të tërheqë cilëndo pikë nga agjenda.
- (2) Të gjitha mbledhjet do të zhvillohen me përdorimin minimal të materialeve të shtypura.

V. Pjesëmarrja në mbledhje

Neni 5

- (1) Rektori dhe Sekretari i përgjithshëm ftohen të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet dhe do të tërhiqen sipas rastit kur Kryetari i Bordit të Universitetit deklaron se, çështjet që do të diskutohen, i përfshijnë të dhënat personale të individëve, siç përcaktohen në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
- (2) Anëtarët e tjerë të Drejtorisë së Rektoriale , apo cilido anëtar tjetër i stafit të Universitetit, mund të ftohet nga Kryetari i Bordit i Universitetit, për të paraqitur çështje të veçanta.
- (3) Kryetari i Parlamentit Studentor ftohet të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet dhe do të tërhiqet kur Kryetari i Bordit të Universitetit deklaron se çështjet që do të diskutohen përfshijnë të dhënat personale të individëve, siç përcaktohen në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
- (4) Kryetari i Senatit mund të ftohet për të paraqitur raport mbi punën e Senatit.
- (5) Në bazë të nenit 23, paragrafit 6, të Statutit, të gjithë anëtarët pritet të marrin pjesë në mbledhjet e caktuara, me njoftimin e duhur. Me përjashtim të rasteve të sëmundjes, ose angazhimeve të tjera të pashmangshme të njoftuara paraprakisht te Sekretari i përgjithshëm, anëtarët që nuk marrin pjesë në dy mbledhje radhazi, automatikisht pushojnë së qeni anëtar.

VI. Mbajtja e mbledhjeve

Neni 6

- (1) Mbledhjet e Bordit të Universitetit në bazë të neneve 28 dhe 29, të Statutit, do të mbahen sipas ligjit të zbatueshëm për subjektet jofitimprurëse.
- (2) Kryetari i Bordit të Universitetit aktualisht vepron si Kryesues i Bordit të Universitetit, vendos se kush mund të flasë dhe kur e pranon, ose e hedh poshtë çdo propozim për miratim, mban rregull dhe vendos për kohën e caktuar për çështjet në agjendë.
- (3) Kuorumi për mbajtjen e një mbledhje të Bordit të Universitetit është pjesëmarrja e 4 nga 7 anëtarë, nga të cilët të paktën një anëtar është nga ata të emëruar sipas nenit 22, paragrafit 5, pikës 1 dhe të paktën një anëtar tjetër është nga ata të emëruar sipas nenit 22, paragrafit 5, pikëve 3 dhe 4, të Statutit.
- (4) Vendimet normalisht merren me konsensus. Nëse kërkohet një votë nga cilido anëtar, vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote, përveç nëse nuk parashikohet ndonjë formë e veçantë e votimit për çështjen e specifikuar në nenin 28, paragrafin 2, të Statutit.

- (5) Kryesuesi ka votë të thjeshtë edhe vendimtare.
- (6) Në rast të ndonjë sfide ndaj një vendimi të marrë nga Kryesuesi, atëherë sfida do të ketë përparësi ndaj çdo çështje tjetër dhe Nënkryetari i Bordit të Universitetit do ta marrë kryesimin e mbledhjes përderisa diskutohet për çështje të tilla.
- (7) Kryesuesi i mbledhjes së Bordit të Universitetit mund të ndërrohet vetëm me shumicën e dy të tretave të anëtarëve të pranishëm dhe me të drejtë vote, të cilët zgjedhin një anëtar nga mesi i tyre, i cili do të kryesojë me atë mbledhje. Sekretari i përgjithshëm do ta marrë kryesimin për këtë pikë të rendit të ditës.

VII. Takime publike dhe shpallja e agjendave dhe raporteve

Neni 7

- (1) Sipas nenit 11, të Statutit dhe sipas kapacitetit të sallës së mbledhjeve, mbledhjet e Bordit të Universitetit janë publike, përveç rasteve kur diskutohen çështje të ndjeshme. Vendimi, mbi atë çështje të ndjeshme, merret nga Kryetari i Bordit të Universitetit, i këshilluar nga Sekretari i përgjithshëm.
- (2) Agjenda përfundimtare e mbledhjeve të Bordit të Universitetit, do të publikohet në ueb faqen e Universitetit, në të njëjtën kohë kur do t'u dërgohet anëtarëve të Bordit të Universitetit dhe të pranishmëve.
- (3) Raportet informuese të mbledhjeve të Bordit të Universitetit, të miratuara aktualisht nga Kryetari i Bordit të Universitetit, vendosen në ueb faqen e Universitetit, jo më vonë se shtatë ditë pune pas mbledhjes përkatëse.
- (4) Procesverbali zyrtar i mbledhjes së Bordit të Universitetit publikohet, në ueb faqen e Universitetit, kur draft-procesverbali miratohet në mbledhjen pasuese.
- (5) Anëtarët e Bordit të Universitetit nuk janë të autorizuar, që palëve të treta t'ua komunikojnë vendimet Bordit të Universitetit, pa pëlqimin paraprak të Kryetarit të Bordit të Universitetit.

VIII. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 8

- (1) Sipas nenit 118, të Statutit, anëtarët ekzistues të Bordit të Universitetit kanë mandat deri më 31 gusht 2020.
- (2) Në nenin 4, paragrafin 1, të kësaj rregulloreje, "një vit" zëvendësohet me "gjashtë muaj" për vitet akademike 2018/2019 dhe 2019/2020.
- (3) Në nenin 7, paragrafin 1, të kësaj rregulloreje, dispozitat për qasjen e publikut hyjnë në fuqi nga 1 nëntor 2019.

Neni 9

Kjo rregullore hynë në fuqi nga 01.10.2019.